



Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave Urbane
Universiteti POLIS

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT

Shkurt 2009

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave Urbane, si institucion edukues dhe kërkimor shkencor, përfaqëson bindjen se zhvillimi i Shqipërisë në të ardhmen do të vijë vetëm si rezultat i ngritjes së kapaciteteve njerëzore në të gjitha fushat, pjesë e të cilave janë edhe arkitektura, urbanistika dhe planifikimi urban.

Misioni i Universitetit:

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave Urbane është institucion privat, laik i arsimit të lartë me karakter mësimor e shkencor. Misioni i tij është:

- të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë, e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore shkencore dhe shërbimeve në fushat e arkitekturës, urbanistikës dhe planifikimit urban; të formojë specialistë të lartë e të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- të mundësojë formimin e vazhduar gjatë gjithë jetës,
- të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar e rajonal;
- të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Objektiva strategjik:

- Të pajisë studentët me cilësitë e lidhshme profesionale në fushat e arkitekturës, urbanistikës dhe planifikimit urban në mënyrë që të ushtrojnë influencën për përmirësimin e situatës aktuale në vend dhe rajon;
- Të pajisë studentët me dije në përshtatje me kërkesat dhe problematikën në rritje për këto shërbime si edhe standartet më të larta bashkëkohore duke synuar përshtatjen e specialistëve të kësaj shkolle jo vetëm brenda vendit por edhe në çdo vend tjetër jashtë Shqipërisë;
- Të ofrojë studime në nivelin e masterit për fushat e përcaktuara më sipër;
- Të kryejë aktivitete studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon;
- Të organizojë dhe të ofrojë studime doktorature në fushat e përcaktuara më sipër.

Programet e studimit në U_POLIS përkatësisht në atë të Arkitekturës dhe Dizajnit Urban si dhe në atë Palnifikimit dhe Menxhimit Urban janë dizenuar që të :

- Mundësojnë studentëve që të kualifikohen personalisht dhe të kenë qasje akademike (Long Life learning).
- Përkrah mësimin dhe të mësuarit.
- Të jemi pro-aktiv në zhvillimin/ përdorimin e metodave të reja si të mësuarit elektronik(e-learning)

Do ti pajisë studentët me:

- Me të menduarin dhe të punuarin bashkëkohor dhe kërkimeve në fushat e arkitekturës, urbanistikës dhe planifikimit urban
- Mësimdhënës kreativ me metoda bashkohore.
- Nivel të lartë të përkrahjes për avancim personal.
- Mundësi pjesëmarrje në organizime të ndryshme të mësimin, hulumtimit dhe punës në praktikë.
- Kualifikimi i stafit nga universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si garanci për diversitet dhe cilësi.
- Kualitet i lartë mësimdhënës, ambjent dhe akomodim social, duke i angazhuar në jetë sociale dhe kulturore.
- Lokacion fizik të përshtatshëm që garanton qetësi dhe ambjent të përshtatshëm [une dhe studimi.

RELACION STRATEGJIK I U_POLIS

Universiteti POLIS është duke ndërtuar reputacion të merituar për ti pajisur studentët me përvojë akademike dhe praktike, duke mundësuar që paralelisht më këtë të krijojë atyre kualifikim superior në tregun e punës. Kapaciteti, cilësia dhe vazhdimësia në mësim dhe përvetësim si për institucionin edhe për studentët do të jenë pika fundamentale për zhvillim të ardhshëm.

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATMEËM në periudhën 3-5 vjet përfshin:

Objektivat e organizimit institucional

- Krijimit të identitetit të formimit akademik dhe profesional për fushat që mbulon veprimtaria e U_POLIS
- Vendosijes së lidhjeve me tregun e punës që përpara diplomimit dhe themelimi i zyres së "kariere" për të sjelle informacion mbi tregun e punës dhe mundësitë e punësimeve konkrete.
- Asistencë dhe mbështetje për kualifikim të stafit akademik

Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit

- Përmirësimeve të vazhdueshme dhe konsolidimit të planit dhe programeve mesimore në përputhje me objektivat e formimit, problemet e vërejtura në zbatim dhe "feed-back" të marra nga studentet

Objektivat e Partneritetit me të Huaj

- Zbatimit dhe thellimit të metejsheve të marrëveshjeve të lidhuara me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit; Fokusimi tek partneret strategjike dhe diversifikimi i lidhjeve.
- Anëtarësimi në shoqata dhe organizma ndërkombëtarë si edhe pjesëmarrjes në aktivitete në kuadrin e këtyre anëtarësimeve.

Objektivat e implementimit të programit të studimit (stafi, hyrjet, infrastruktura)

- Përmirësimi të mjediseve ekzistuese të mësimdhënies së U_POLIS dhe identifikimi i një objekti të ri për zhvillimin e veprimtarisë së U_POLIS;

Objektivat e kërkimit shkencor

- Gjallërimi të aktivitetit shkencor të departamenteve hulumtuese- botimi i librave rezultat i kërkimit shkencor dhe punimeve/teksteve të hartuara nga pedagogët.

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATGJATË mbi 5 vjet përfshin:

Objektivat e organizimit institucional

- Forcimit të lidhjeve me tregun e punës dhe të mbështetjes së studentët në punësim.

Objektivat e Hartimit të Programeve të Studimit

- Permiresimeve të vazhdueshme në planin dhe programet e studimit si edhe të gjithë elementeve të tjera të lidhur me to në përputhje me arritjen e objektivave të formimit dhe impaktit shoqëror;
- Krijimit dhe konsolidimit të kushteve për studime të nivelit të tretë të arsimit të lartë kryesisht programeve studimore të doktoratës duke konkluduar me plotësimin e të gjitha cikleve dhe titujt e studimeve të arsimit të lartë në U_POLIS;
- Marrjes së “feed-back” të vazhduar nga studentet e diplomuar për të parë ecurinë dhe për përmirësimet në procesin e formimit dhe për të ndermarrë korrigjimet përkatëse në të gjithë elementet e formimit në U_POLIS në përputhje me këto. “feed-back”

Objektivat e Partneritetit me të Huaj


- Anëtarësimin në shoqata dhe organizma ndërkombëtarë si edhe pjesëmarrjes në aktivitete në kuadrin e këtyre anëtarësimeve.
- Thëllimit të mëtejshëm të marrëveshjeve të lidhuara me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit.

Objektivat e implementimit të programit të studimit (stafi, hyrjet, infrastruktura)

- Rritjes së shkallës së mbështetjes së studentëve në nevojë duke aplikuar dhe programe bursash për studentë të kategorive të ndryshme;
- Krijimit të imazhit jo vetëm të bazuar në një objekt të ri dhe simbol, por mbi të gjitha në identitetin e filozofisë së formimit dhe impaktit shoqëror

Objektivat e kërkimit shkencor

- Kryerjes dhe publikimit të studimeve shkencore që i vijne në ndihmë praktikës për fushat që mbulon veprimtaria akademike e U_POLIS dhe ajo kërkimore e praktikës së IKSH.



Strategjia e Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë parashikon këtë plan veprimi:

- Krijimi i marrëveshjeve të reja të binjakëzimit me institucionet më prestigjioze të arsimit të lartë në vend dhe në botë
- Shkëmbimi i studentëve dhe profesorëve me universitetet me të cilat është aritur marrëveshja
- Krijimi i partneritetit për aplikimin në programet e Bashkimit Evropian sic është Tempus, SCM, Erasmus, Erasmus Mundus .
- Bashkëpunimi afatgjatë përmes krijimit të Departamenteve të Përbashkëta për Studime (Joint programmes).

Strategjia e përmirësimit të cilësisë së brendshme:

politikë e Cilësisë së Brendshme përshin këto rubrika: komisionet e vlerësimit, planin e zhvillimit institucional të cilësisë, mënyrat e vlerësimit, udhërrëfyes për vlerësimin e mësimdhënies, burime dhe metoda për vlerësimin e mësimdhënies, dosja e pedagogut dhe procedurat e rivlerësimit. Mjetet përmes të cilave synohet të realizohen janë:

- Rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mësimnxënies, mësimdhënies, hulumtimit dhe shërbimeve përkrahëse për studentët dhe stafin;
- Përdorimit aktiv të planifikimit dhe procesit të vetëvlerësimit lidhur me misionin e Universitetit;
- Zhvillimit dhe përdorimit të komunikimit efektiv dhe punës në ekip pozitive;
- Shpërndarjes efektive, funksionimit dhe rishikimit të politikës së cilësisë si dhe procedurave dhe proceseve;
- Zhvillimi i cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe i ambientit të punës
- Qartësimi i planit të zhvillimit institucional të cilësisë me të gjithë stafin i cili do të kontribuojë në rritjen e cilësisë

- Kualifikime per pedagoget qe kontribuojne ne perfeksionimin e menaxhimit te procesit mesimor.

Stafi akademik:

U_POLIS do të ofrojë staf me këto karakterstika:

- Edukim bashkëkohor dhe përvojë në mësimdhënie, vlerësimi dhe orientimi drejt edukimit dhe nevojave të studentëve
- Qasje akademike për procesin mësimor duke aluduar rëndësinë e kërkimit shkencor
- Integrim i aftësive zhvillimore në plan-program , të reflektuara në mtoadat e organizimit të kursit dhe në vlerësim
- Aftësi në krijimin e një ambjenti dinamik me studentët
- Aftësi të punojë si pjesë e ekuipit të U_POLIS
- I përkushtuar në standarte të larta , i përgatitur që të përkrah, zhvillojë dhe realizojë aktivitetet kur ti kërkohet.
- Aftësi për të komunikuar në mënyrë të njëjtë si në formë të shkruar dhe atë verbale.

Programi për mbështetje financiare:

- Punësim të kufizuar të studentëve në kuadër të IKSH_POLIS.
- Punësim veror në studio arkitekture të ndryshme të identifikuar nga Zyra e Karrierës.

Universiteti mundëson për studime akademike që studentët të aplikojnë për mbështetje financiare përmes:

- Bursave

Për të arritur këto objektiva Universiteti duhet të plotësojë:

1. Të sigurohet se plani programi është bërë në bazë të një planifikimi paraprak të bazuar në kërkime dhe punë praktike, dhe ku studentët të kenë mundësi të kontribuojnë në zhvillimin e formës dhe përmbajtjes së plan-programit.
2. Të zhvillojë dhe mundësojë lidhshimin profesional në fushat e arkitekturës, urbanistikës dhe planifikimit urban.
3. Të përzgjedhe dhe rekrutojë stafin e kualifikuar akademik në fushat e mësipërme.
4. Të integrojë teknika dhe metoda bashkëkohore në procesin mësimor dhe kërkim shkencor.
5. Të tërheqë grupe të studentëve përmes metodave fleksible të studimit pasuniversitare duke krijuar partneritet strategjik me institucionet e tjera të edukimit në vend dhe jashtë, duke krijuar kështu alternativa shtesë për edukim adekuat.
6. T'i përgjigjë nevojave të studentëve në aspektet e jetës studentorë (akademike dhe shoqërore).
7. Të krijojë një bazë financiare të qëndrueshme që mundëson infrastrukturë të përgjithshme për sistem edukimi, pasqisje dhe akomodim për mësim, materiale mësimore si dhe mjedis social.
8. Të implementojë strategjinë e edukimit në mënyrë të vazhdueshme.